

Njoftim për Kontratë Shërbimi Terma Reference

Pozicioni:	Ekspert/Grup ekspertësh për ofrimin e shërbimeve të specializuara (trajtim psikologjik individual, terapi, këshillim, logopedi, etj)
Projekti:	Përgjigje ndaj rrezikut të shtuar të abuzimit të fëmijëve dhe ndarjes nga familja shkaktuar nga emergjencat në Shqipëri
Zonat e projektit:	Rajonet Tiranë, Shkodër, Durrës, Elbasan, Lezhë, Kukës, Korçë dhe Vlorë
Lloji i kontratës:	Kontratë shërbimi
Kohëzgjatja:	Gusht-Nëntor 2021

Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS kërkon të kontrakttojë **një ekspert ose grup ekspertësh në ofrimin e shërbimeve të specializuara (psikoterapi, terapi zhvillimi, logopedi, etj) në kuadër të projektit “Përgjigje ndaj rrezikut të shtuar të abuzimit të fëmijëve dhe ndarjes nga familja shkaktuar nga emergjencat në Shqipëri”** zbatuar në partneritet me UNICEF.

Informacion i Përgjithshëm:

Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS (shkurtimeisht NISMA) është një organizatë jofitimprurëse, e cila është themeluar në shkurt të vitit 2016. NISMA është një aktor jo qeveritar me influencë në sektorin e shoqërisë civile në Shqipëri.

Misioni i NISMA është të ofrojë shërbime dhe zgjidhje të qëndrueshme për individë dhe grupet më të margjinalizuara në shoqërinë shqiptare me theks të veçantë në komunitetet Rome dhe Egjiptiane. NISMA advokon dhe lobon në nivel lokal dhe qendror mbi çështjet e mbrojtjes së fëmijëve dhe të rinjve, zhvillimit dhe pjesëmarrjes, përmirësimit të kushteve social-ekonomike të familjeve të tyre dhe fuqizimit të kapaciteteve të shërbimit ofruesve, organizatave jofitimprurëse, profesionistëve dhe aktorëve të tjerë të cilët punojnë me fëmijët në situatë vulnerabël.

Përshkrim i projektit:

Projekti ka si qëllim të ofrojë dhe sigurojë përgjigje ndaj nevojave emergjente në Shqipëri për të reduktuar pasojat e shkaktuara nga tërmetet dhe pandemia e COVID-19, në rajonet e prekura si Tiranë, Shkodër, Durrës, Elbasan, Lezhë, Kukës, Korçë dhe Vlorë. Projekti fokusohet në përpjekjet për të siguruar mbrojtje sociale për grupet në nevojë të prekur nga pasojat e emergjencave të ndodhura në vend. Projekti është në të njëjtën linjë dhe në reagim të koordinuar me masat e ndërmarra nga Qeveria Shqiptare për përgjigjen ndaj pasojave të shkaktuara nga tërmeti dhe pandemia COVID-19, me strukturat në nivel qendror si Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe strukturat në nivel lokal në bashkitë e targetuara nga projekti. Projekti fokusohet jo vetëm në mbështetje të familjeve dhe fëmijëve të prekur nga emergjencat, por edhe pilotimin e shërbimeve të reja mbështetëse për fëmijën dhe familjen, familjet kujdestare profesionale si dhe ngritja e kapaciteteve për punonjësit që janë pjesë e ofrimit të shërbimeve dhe kujdesit social.

Kjo ndërhyrje do të zhvillohet paralelisht dhe në përputhje të plotë me *Planin Kombëtar të Deinstitutionalizimit*, të miratuar në bazë të **VKM-së Nr.706, dt.09.09.2020**, e cila synon të zhvillojë politika, programe dhe shërbime për parandalimin e ndarjes së fëmijës nga familja, fuqizimin e

shërbimeve të kujdesit alternativ me bazë familjen dhe transformimin për kalimin gradual nga kujdesi alternativ rezidencial drejt shërbimeve të kujdesit me bazë komunitare për fëmijët dhe familjet e tyre.

Grupet përfituese dhe aktorët kyç:

- Prindër/ kujdestarë të identifikuar në nevojë për mbrojtje ose në nevojë për referim në shërbimet e kujdesit social;
- Fëmijë të vlerësuar në risk të mesëm ose të lartë ndaj shfrytëzimit, dhunës apo abuzimit;
- Fëmijë të vendosur në shërbimet e përkujdesit shoqëror rezidencial;
- Familje me fëmijë në risk për tu institucionalizuar;
- Punonjës të strukturave vendore, përgjegjës për mirëqenien e fëmijëve;
- Punonjës të sistemit të mbrojtjes së fëmijëve.

Detyrat dhe përgjegjësitë për secilin ekspert:

Eksperti psikolog/terapist zhvillimi:

- Psikologu/terapisti i zhvillimit, vlerëson gjendjen e fëmijëve të identifikuar në nevojë për vlerësim dhe vendos objektivat për ndërhyrjen, në drejtim të:
 - problemeve psiko-emocionale dhe shkallës së zhvillimit të tyre,
 - nivelit të aftësive kognitive dhe aftësive në fusha të ndryshme,
 - problemeve të sjelljes, ritualet, stereotipet, agresivitetin apo çrregullimet perceptive,
 - identifikon pikat e forta dhe pikat e dobëta të fëmijës,
 - përcakton fushat e ndërhyrjes së menjëhershme.
- Ofron terapi individuale të zhvillimit dhe sjelljes në ambientin familjar të fëmijës apo në institucionin ku fëmija është rezident, bazuar në vlerësimin e fëmijës me qëllim të:
 - mbështetjes së fëmijës për të reduktuar problemet e sjelljes (sjelljes agresive, episodeve të mungesës së kontrollit nga zemërimi, tolerancës së ulët, sjelljet vetë-dëmtuese, balancimin e sjelljeve të tilla si tërheqja sociale etj),
 - të nxisë aftësitë e përshtatjes,
 - problemet psiko-emocionale,
 - ndihmon aktivitetin fizik të fëmijës, të tilla si: aftësitë e motorikës fine dhe globale, koordinimin sy-dorë, kryen lojëra për të promovuar ekuilibrin dhe aftësitë motorike, duke përdorur mjetet e duhura.
- Ofrimin e këshillimit psikologjik dhe mbështetjes për fëmijët: Fëmijët dhe anëtarët e familjes/kujdestarët do të kenë kohë për të diskutuar për sfidat e tyre, të mësojnë në lidhje me zgjedhjet, vetë-përgjegjësisë dhe vetë-drejtimin, zgjidhjen e vështirësive emocionale dhe dinamikat që lindin nga vështirësitë zhvillimore
- Ofron mbështetjen dhe zhvillimin e fëmijës, strategji të sjelljes dhe motivim, si dhe aftësi të tjera bazë që lehtësojnë aftësinë e fëmijës për të mbështetur arsimimin dhe zhvillimin e tyre.
- Përgatit raporte periodike mbi ecurinë e zhvillimit të trajtimit dhe ofron sugjerimet për përmirësimin në tërësi të këtij procesi.

Profili i ekspertit psikolog/terapist zhvillimi :

I. Kualifikime

- Diplomë universitare/pasuniversitare në psikologji.

- Të ketë ndjekur trajnime kualifikuese shtesë në psikoterapi, terapinë e zhvillimit, këshillimit.
- Të jetë e/i çertifikuar për Metodën ABA.

II. Eksperienca e punës

- Të ketë jo më pak se 3 vite eksperiencë pune në ushtrimin e profesionit të tij/saj në qendra që ofrojnë shërbime të specializuara psikologjike për fëmijët.
- Të ketë eksperiencë pune në ekip multidisiplinar për vlerësim dhe ngritje e plani të zhvillimit/trajtimit.
- Njohuri shumë të mira në gjuhën angleze në formën e shkruar dhe të folur;
- Aftësi shumë të mira në arritjen e afateve;
- Aftësi shumë të mira në komunikim, dhe zgjidhje konfliktesh;
- Aftësi për të punuar në presion kohe, në punë në grup dhe në mënyrë të pavarur.

Eksperti logoped/terapist i të folurit, pritet të:

- Logopedi/Terapisti i të folurit vlerëson nevojat e fëmijës në lidhje me gjuhën dhe komunikimin si më poshtë:
 - Vëzhgon fëmijën dhe vlerëson natyrën e çrregullimeve të komunikimit që ai përfaqëson,
 - Vlerëson aftësinë e fëmijës për të komunikuar
 - Vlerëson aftësinë për të kuptuar (udhëzimet verbale me 1,2 hapa, gjestet, kontekstin)
 - Vlerëson problemet motorike që ndërhyjnë në vokalin e fëmijës
 - Vlerëson mënyrën e shqiptimit
 - Vlerëson gabimet sintaksore gjatë komunikimit
 - Vlerëson aftësitë e gjuhës basale të fëmijës
 - Vlerëson mënyrën se si fëmija kryen kërkesat, përsërit fjalët, dialogun, etj
 - Vlerëson komunikimin social dhe komunikimin jo-funksional (ekolalia)
 - Vlerëson aftësinë e fëmijës për të imituar.
- Përcakton natyrën e ndërhyrjes dhe nr. e seancave të të folurit (në mënyrë individuale dhe në grup) që fëmija ka nevojë për të ndjekur.
- Përgatit Planin e ndërhyrjes për trajtimin e problematikave të identifikuara :
 - Trajnon fëmijën të përdorë kërkesat, komandat interaverbale, etj.
 - Trajnon fëmijën të kuptojë (emërtimin e objekteve, pjesëve të trupit, tiparet, etj)
 - Trajnon fëmijën për të imituar, dhe të përdorë gjeste për të komunikuar,
 - Trajnon fëmijën për të përdorur PECS (Sistemin e komunikimit nëpërmjet ndryshimit të figurave).
 - Kombinon trajnimin për komunikim me seancat e tjera të terapisë së zhvillimit, etj
- Ka njohuri mbi përdorimin e teknologjisë ndihmëse dhe të formave të tjera të komunikimit që lehtëson komunikimin e fëmijëve me çrregullime të të folurit.
- Bashkëpunon dhe këshillon familjen/kujdestarët dhe stafin e institucionit rezidencial mbi teknikat që ata mund të përdorin për të përmirësuar komunikimin e fëmijës.
- Raporton rregullisht për zbatimin e planit individual të komunikimit dhe zhvillimit dhe ofron sugjerimet për përmirësimin në tërësi të këtij procesi.

Profili i Ekspertit logoped/terapist i të folurit:

I. Kualifikime

- Diplomë universitare/pasuniversitare në psikologji/logopedi.
- Të ketë ndjekur trajnime kualifikuese shtesë në fushën e logopedisë dhe terapisë së të folurit.
- Të jetë e/i çertifikuar për Metodën ABA.

II. Eksperienca e punës

- Të ketë jo më pak se 3 vite eksperiencë pune në ushtrimin e profesionit të tij/saj në qendra që ofrojnë shërbime të specializuara për fëmijët.
- Të ketë eksperiencë pune në ekip multidisiplinar për vlerësim dhe ngritje të planit individual të trajtimit/zhvillimit.
- Njohuri shumë të mira në gjuhën angleze në formën e shkruar dhe të folur;
- Aftësi shumë të mira në arritjen e afateve;
- Aftësi shumë të mira në komunikim, dhe zgjidhje konfliktesh;
- Aftësi për të punuar në presion kohe, në punë në grup dhe në mënyrë të pavarur.

Punonjësi psikoterapist/psikolog klinik, pritet të:

- Të ndihmojë në zhvillimin dhe përditësimin e planeve individuale të zhvillimit të fëmijëve të identifikuar me probleme sjellore dhe emocionale;
- Të kryejë seanca terapeutike 50 minutëshe individuale në IPSH (Institucion i Përkujdesit Shoqëror);
- Të përdorë ndërveprimin verbal dhe ndërveprimin përmes artit dhe lojës, për të eksploruar sjelljet, mendimet dhe emocionet e fëmijës;
- Të inkurajojë fëmijën të shprehë në mënyrë konstruktive (përmes fjalëve, lojës, artit) konfliktet e tij të brendshme;
- Të ndihmojë fëmijën të zhvillojë strategji menaxhimi konstruktive për të përballuar zemërimin, emocione të tjera të forta dhe situata stresante në të përditshmen e tij/saj;
- Të mbajë shënime pas çdo seance. Konfidencialiteti i seancave duhet të ruhet, por në çdo seancë psikoterapisti duhet të raportojë për vëzhgimet në sjelljen e fëmijës;
- Të ndihmojë në zhvillimin e një plani ndërhyrjeje përballimi për të përditshmen e fëmijës, me hapa të qartë e konkretë, për kujdestaret/prindërit e fëmijës;
- Të zhvillojë një plan veprimi për çdo situatë krize emocionale dhe sjellore që fëmija mund të kalojë në institucion;
- Të përfshijë dhe të ofrojë psikoedukim për kujdestaret dhe punonjëset e tjera të institucionit për procesin e trajtimit të fëmijës.
- Psikoterapisti duhet të mbajë një ditar për shënime pas çdo seance me fëmijën.
- Psikoterapisti duhet të raportojë çdo 4 seanca për ecurinë e fëmijës lidhur me emocionet, mendimet dhe sjelljet e fëmijës.

Profili i psikoterapist/psikolog klinik:

I. Kualifikime

- Diplomë universitare/pas universitare në psikologji.
- Të ketë ndjekur trajnime kualifikuese shtesë në fushën e psikoterapisë (CBT, Trapi Sjellore e Avancuar përbën avantazh).

II. Eksperienca e punës

- Të ketë jo më pak se 3 vite eksperiencë pune në ushtrimin e profesionit të tij/saj individualisht ose klinika të specializuara.
- Të ketë eksperiencë pune në ekip multidisiplinar për vlerësim dhe ofrim psikoterapie.
- Njohuri shumë të mira në gjuhën angleze në formën e shkruar dhe të folur;
- Aftësi shumë të mira në arritjen e afateve;
- Aftësi shumë të mira në komunikim, dhe zgjidhje konfliktesh;
- Aftësi për të punuar në presion kohe, në punë në grup dhe në mënyrë të pavarur.

Politikat e Mbrojtjes së Fëmijëve: Të gjithë personat që punojnë me programet e NISMA janë të detyruar të respektojnë politikat e mbrojtjes së fëmijëve, politikat e mbrojtjes nga abuzimi dhe shfrytëzimi seksual, kodin e sjelljes bashkëngjitur me termat e referencës.

Procedura e Aplikimit:

Aplikantët e interesuar për të aplikuar për secilin nga pozicionet e sipër shënuara duhet të dërgojnë me email CV-në e tyre, një letër interesi, një përmbledhje të profilit profesional dhe ofertën financiare që lidhet me pozicionin (maksimumi një faqe) për NISMA në adresën e emailit: initiative.arsis@gmail.com deri në datën **27 Gusht 2021**, mesnatë. *Në vemendjen tuaj që në subjekt të emailit ku dërgohet aplikimi të vendoset: Aplikim për pozicionin e ekspertit në shërbimet e specializuara.*

Procedura e Vlerësimit:

Zgjedhja e personit do të bazohet në: se sa mirë aplikimi përmbush kërkesat e përcaktuara në termat e referencës, gjithashtu edhe bazuar në tabelën e vlerësimit të mëposhtëm.

Kriteret e vlerësimit	Vlerat në %
Kualifikime	30%
Eksperiencë pune	50%
Oferta financiare	20%

Ju lutem konsideroni që vetëm kandidatët e përzgjedhur për intervistë do të kontaktohen.